



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_. \_\_. \_\_\_\_\_

**Proces-verbal**

**Mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile**

I mbajtur sot më datë 15.02.2017 në orën 12:30 në ambientet e Kryeministrisë me rend dite:

1. Fjala përshëndetëse;
2. Prezantimi, diskutimi i draftit të Rregullores së Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe miratimi;
3. Zgjedhja e zëvendëskryetarit të KKShC- së;
4. Prezantimi i Udhërrëfyesit për hartimin e politikës dhe masave për një mjedis mundësues për shoqërinë civile;
5. Përzgjedhja e grupit që do të hartojë kalendarin dhe aktivitetet kryesore për muajin në vijim;
6. Ngritja e grupeve të punës për të tri fushat e veprimit dhe diskutimin e çështjeve konkrete që pritet të ngrihen për diskutim nga anëtarët e shoqërisë civile në KKShC;

Të pranishëm konfirmohen anëtarët si më poshtë:

1. Z. Blendi Klosi;
2. Znj. Majlinda Dhuka;
3. Znj. Nora Malaj;
4. Znj. Eralda Cani;
5. Z. Blendi Dibra;
6. Z. Eridian Salianji;
7. Z. Vladimir Thanu;
8. Z. Ergys Gezka;
9. Z. Genc Boga;
10. Z. Ilir Marko;
11. Z. Luan Ahmetaj;
12. Z. Ali Coka;
13. Znj. Kozara Kati;
14. Znj. Emanuela Zajmi;
15. Artemisi Shehu;
16. Mirela Koçi;
17. Znj. Ina Nanushi;
18. Znj. Erisa Lame;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE**

---

Fjalën e merr z. Klosi i cili përshëndeti: Mirëdita dhe më vjen mirë që në kuadër të politikave që kemi ndërmarrë për shoqërinë civile dhe në zbatim të Ligjit Nr. 119/ 2015 “Për Krijimin dhe Funksonimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”. Në vazhdim të fjalës përshëndetëse, z. Klosi theksoi se ngritja e KKShC- së është një moment historik sepse në kuadër të implementimit të politikave në raport me shoqërinë civile, ky Institucion i ri përbën gjithë përpjekjet tona për gjetjen e mundësisë dhe hapësirave që zëri i shoqërisë civile të përhapet edhe më shumë. Reformat e ndërmarra nga shteti shqiptar duke përmendur reformat ekonomike dhe sociale, janë mbështetëse e iniciativave të shoqërisë civile. Kjo mbledhje e parë, dëshmon thirrjen dhe përpjekjen që bën qeveria shqiptare në mënyrë që t’i shërbejë sa më mirë qytetarëve. Z. Klosi prezanton rendin e ditës dhe kërkon prezantimin e pjesëmarrësve.

12:38: Z. Kananaj shpreh dakortësinë e tij për rendin e ditës dhe fjalën e z. Klosi.

12:39: Z. Ahmetaj: Nis prezantimin e tij duke falenderuar iniciativën e ndërmarrë.

12:40: Z. Thanu shprehet lidhur me garantimin për promovimin e këtij institucioni dhe propozon ndryshimet e Ligjit për Shoqërinë Civile duke pasur parasysh vlerat e mbështetura nga organet qendrore dhe OJF-të.

12:41: Znj. Zaimi shprehet për mandatin që fillon nga dita e sotme dhe mirënjohjen. Ajo shprehet se sheh me vlerë bashkëveprimin për sa i përket politikave dhe nismave ligjore dhe thotë se çdo gjë është më mirë të konsultohet në Këshill përpara se të kalojë në Parlament.

12:43: Z. Coka përshëndet dhe uron që KKSHC të japë edhe më tepër përparësi zhvillimit të agro-turizmit me qëllim që të përthithen investimet e huaja.

12:45: Znj. Kati shprehet: “Të dashur miq, kolegë. Sot më në fund pas shumë lodhjes arritëm të mbledhemi në një tavolinë. Unë përfaqësoj Bordin e AMSHC-së në pamundësi të pjesëmarrjes së z. Thanu, dhe në emër të tij ju përshëndes duke ju uruar suksese dhe punë të mbarë.

12:47: Z. Klosi falenderon për opinionet dhe kalon në pikën dytë të rendit të ditës. Pasi pyet nëse ka ndonjë koment tjetër mbi Draftin e Rregullores së KKSHC-së.

12:49: Z. Gezka u shpreh se është një punë e bërë mirë referuar Rregullores duke cituar nenin 7 i cili ka nevojë të rishihet.

12:50: Z. Saliçani u shpreh se nuk ka kuptim të ekzistojë neni 8 (Komiteti Drejtues) duke qenë se vetë Këshilli është një organ i tillë dhe në këtë rast do të kemi mbivendosje organesh. Ndaj propozoj të hiqet neni 8 dhe neni 9 rrjedhimisht në nenin 7.

12:52: Znj. Nanushi shprehet se ka kundërshtim për çfarë u shpreh me lart.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE**

---

12:53: Znj. Zaimi thotë: “Të kihet parasysh zëvendësimi sipas ligjit dhe jam e mendimit që Rregullorja të miratohet sot. Jam dakord me komunikimin për diskutimin e deritanishëm.”

12:55: Znj. Dhuka prezantohet duke thënë se jam Zv. Sekretare e Përgjithshme e Këshillit të Ministrave dhe Zv. Kryetare e Bordit Mbikëqyrës të AMSHC-së. Komunikimi mbi Draft-Rregulloren është përcjellë zyrtarisht.

12:56: Z. Klosi u shpreh se s’duhet të ketë zëvendësime të anëtarëve të Këshillit, veçanërisht për shoqërinë civile dhe propozoi të miratimin në parim të Rregullorës, me klauzolën që në mbledhjen e ardhshme të ndryshohet nëse do të ketë ndryshime.

12:56: U hodh në votim Rregullorja dhe z. Klosi u shpreh: “Kush është pro të ngrejë dorën?”

Të gjithë anëtarët si më poshtë z. Klosi; znj. Dhuka; znj. Malaj; znj. Cani; z. Dibra; z. Salianji; z. Thano; z. Gezka; z. Marko; z. Ahmetaj; znj. Kati; znj. Zajmi; znj. Nanushi; z. Lame; znj. Shehu dhe znj. Koçi ngritën dorën.

Pastaj pyet: “Kush është kundër?” Asnjëri nga të pranishmit nuk u shpreh.

Pastaj pyet: “Abstenim?” Z. Boga ngriti dorën.

Z. Klosi u shpreh “Miratohet”.

12:57: Z. Klosi lexon nenin për Zv. Kryetarin e KKSHC-së dhe shprehet se ky zv. Kryetar emërohet ndaj nuk duhet të kemi votim. Ky anëtar të zgjidhet nga shoqëria civile.

13:00: Z. Salianji sqaron se emërimi vjen pas votimit nga anëtarët e KKSHC-së.

13:02: Z. Boga shprehet që të mos nxitohemi në zgjedhjen e Zv. Kryetarit.

13:03: Z. Klosi merr fjalën dhe shprehet se materialet duhet të rakordohen në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe nga institucione publike.

13:04: Znj. Zaimi shprehet lidhur me mënyrën e procedimit për Ligjin lidhur me Zv. Kryetarin.

13:05: Z. Klosi shprehet se Ligjin nuk do e ndryshojmë dhe të mos debatojmë për këtë çështje. Anëtarët e shoqërisë civile të dakordësohen dhe ne do e miratojmë.

13:05: Z. Dibra pyet se si do të procedohet me mandatin e anëtarëve.

13:06: Z. Kananaj shprehet se i gjithë procesi është shumë i qartë në nenin e fundit të Ligjit.

13:07: Znj. Cani duhet të jemi të qartë lidhur me mandatin.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE**

---

13:08: Znj. Malaj shprehet: “Është logjikë e thjeshtë. Bëhen llogaritë për secilin anëtar nga shoqëria civile dhe kandidati për Zv. Kryetar i zgjedhur i shtohet mandati në tre vjet nëse mandati i mëparshëm do të jetë më i vogël.”

13:10: Z. Thanó shprehet se sot duhej të hidhej shorti.

13:14: Z. Klosi u shpreh se merr përsipër organizimin e punës dhe me konsensusin e anëtarëve shtyhet zgjedhja e Zv. Kryetarit në mbledhjen e ardhshme.

13:16: Z. Sefa prezanton Udhërrëfyesin për Shoqërinë Civile.

13:45: Z. Klosi falenderon për prezantimin e materialit dhe shprehet se Këshilli ka hapësirë për të ndërhyrë në material. Pastaj kalohet në rendin 5 dhe 6 dhe shprehet se këto pika janë të njëjta dhe duhet të bashkohen e të diskutohen për mbledhjen e ardhshme.

13:52: Znj. Zaimi pyet se ç’ndodh nëse një anëtar i shoqërisë civile ndodhet jashtë vendit për një periudhë një deri në dy vjet.

13:53: Z. Kananaj i përgjigjet duke thënë se kjo të sanksionohet në Rregullore.

13:54: Z. Klosi falenderon të ftuarit që morën pjesë duke theksuar se edhe mbledhjet në vazhdim do të jenë të hapura dhe publike.

Mbledhja u mbyll në orën 13:55.